VENDIM
Nr. 36, datë 30.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i " "
Sokol Berberi	anëtar	i " "
Vitore Tusha	anëtare	e " "
Altina Xhoxhaj	anëtare	e " "
Fatmir Hoxha	anëtar	i " "
Gani Dizdari	anëtar	i " "

me sekretare Edmira Babaj, në datën 10.4.2014, mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 9 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Age Musteqja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria "Fushë Kruja Cement Factory" sh.a.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2013-850 (182), datë 7.3.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131/f, 132/1 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 31, 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila u shpreh për pranimin e kërkesës dhe prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Shoqëria "Fushë Kruja Cement Factory" sh.a., që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja është pronare e një toke me sipërfaqe prej 6470 m2, e ndodhur në vendin e quajtur Zall-Krujë. Kërkuesja e ka fituar pronësinë mbi këtë tokë në vitin 1994 në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

2. Në vitin 2006 fabrika e çimentos "Fushë Kruja Cement Factory" sh.a., ka nisur gërmimet për argjilë në zonën Zall-Krujë. Fabrika ka kryer gërmime dhe në sipërfaqen që i përket kërkueses. Kundër këtyre veprimeve të fabrikës, kërkuesja, në fillim të vitit 2007, ka paraqitur ankim pranë Komunës Thumanë. Meqenëse dëmtimi i pronës nuk po ndalohej, kërkuesja ka paraqitur kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë me objekt pushimin e cenimit të pronësisë, mospërsëritjen në të ardhmen dhe shpërblimin e dëmit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 69, datë 9.2.2010, ka vendosur: "*Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë. Detyrimin e palës së paditur të pushojë cenimin e pronësisë në sipërfaqen 6470 m^2 dhe shpërblimin e paditëses për dëmin e shkaktuar vetëm për 3 vitet e fundit.*"

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 591, datë 11.3.2011, ka vendosur: "Ndryshimin e vendimit nr. 69, datë 9.2.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë duke pranuar kërkesë padinë."

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-850 (182) ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit nr. 69, datë 9.2.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe të vendimit nr. 591, datë 11.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë.*"

II

6. ***Kërkuesja*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë si antikushtetues me argumentet se:

6.1 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji ka tejkaluar kompetencat dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke rivlerësuar provat e marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykata e Apelit Tiranë dhe duke ndryshuar faktet dhe rrethanat.

6.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi përfundimi në të cilin ka arritur ky Kolegj se fitimi i titullit të pronësisë lidhet me momentin e marrjes së certifikatës së pronësisë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme vjen në kundërshtim me vendimin unifikues të vetë Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 6.1.2009.

6.3 Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Kolegjit Civil nuk është arsyetuar në pajtim me kërkesat e dispozitave kushtetuese dhe ligjore lidhur me detyrimin për të arsyetuar një vendim gjyqësor në mënyrë të plotë dhe logjike, në zbatim edhe të praktikës së Gjykatës Kushtetuese për këtë qëllim. Arsyetimi i vendimit është kontradiktor dhe jologjik.

7. ***Subjekti i interesuar, Shoqëria "Fushë Kruja Cement Factory"*** sh.a., ka paraqitur prapësime me shkrim duke parashtruar:

7.1 Pretendimi i kërkueses nuk qëndron, pasi Kolegji Civil ka konstatuar zbatim të gabuar të ligjit dhe për këtë arsye ka vendosur prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta. Në këtë mënyrë, ajo ka respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

7.2 Nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi kërkuesja nuk ka qenë në posedim të pronës së saj në periudhën e viteve 2004-2008, për të cilën kërkuesja pretendon dëmshpërblimin si pasojë e cenimit të pronësisë. Kolegji Civil nuk i ka mohuar të drejtën e pronësisë kërkueses, ai vetëm ka evidentuar se ajo nuk legjitimohet të ngrinte padi për periudhën gjatë të cilës ajo nuk ishte poseduese e sendit në pronësi.

7.3 Arsyetimi i vendimit të Kolegjit Civil është i plotë dhe logjik dhe ka arritur në mënyrë të natyrshme në përfundimin se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin.

III
Vlerësimi i Gjykatës

A. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

8. Kërkuesja pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë një vendim tej kompetencave të tij duke bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Kolegji Civil, duke bërë rivlerësim të provave të marra dhe administruara nga gjykatat më të ulëta, ka vepruar si gjykatë fakti dhe jo si gjykatë ligji, gjë e cila nuk është në përputhje me parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

9. Gjykata, në jurisprudencë të vazhduar, ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi "gjykatë", në kuptimin material, karakterizohet nga funksioni i posaçëm që ka gjykata për të zgjidhur çështjet që janë në kompetencë të saj, gjatë një procesi të zhvilluar sipas një procedure të përcaktuar me ligj dhe në pajtim me parimin e shtetit të së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe fakteve nga Gjykata e Lartë dhe nxjerrja e konkluzioneve të kundërta nga ato të gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*)

11. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me rolin e saj si gjykatë ligji, ka marrë prerogativat e një gjykate fakti, duke tejkaluar kompetencat e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligjin procedural civil. Ky Kolegj ka pranuar disa herë në përmbajtjen e vendimit të tij se hetimi nga dy gjykatat më të ulëta ka qenë i paplotë dhe i pamjaftueshëm. Kështu, ai është shprehur se "Kolegji... i gjen të

pabazuar në prova pretendimet", kur faktet e rrethanat e çështjes janë të provuara me prova të administruara dhe vlerësuar nga gjykatat më të ulëta. Më tej, Kolegji Civil është shprehur në vendimin e tij se *"...të dyja gjykatat e faktit kanë pranuar të provuar që paditësja është bërë pronare e parcelës me Akt të Marrjes së Tokës në Pronësi në bazë të ligjit Për Tokën*", ndërkohë që Gjykata e Lartë pranon që ajo nuk ka qenë pronare në vitin 2004.

12. Gjithashtu, megjithëse në vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta është pranuar e provuar se paditësja e ka fituar pronësinë mbi sendin shumë kohë para dhënies së lejes koncesionare për palën e paditur, kjo gjë nuk pranohet nga Kolegji Civil, i cili shprehet se paditësja është bërë pronare më vonë se kur pala e paditur u pajis me leje shfrytëzimi (faqja 3 e vendimit). Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Kolegji Civil arrin në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat më të ulëta, atëherë ai duhet të prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë për rigjykim çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Ai në asnjë rast nuk mund të zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të elaboruar më lart nga Gjykata.

13. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar tej kompetencave të tij të njohura nga ligji procedural civil duke marrë një vendim në papajtueshmëri me elementët e procesit të rregullt ligjor, konkretisht të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

B. Për pretendimin për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit

14. Kërkuesja pretendon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk është i arsyetuar në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Kolegji edhe pse ka marrë rolin e një gjykate fakti në kundërshtim me ligjin procedural civil, nuk e ka kryer si duhet këtë rol, duke paraqitur një arsyetim të paqartë, jologjik dhe kontradiktor.

15. Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim është i bazuar dhe duhet pranuar. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Një vendim gjyqësor që të jetë mjaftueshmërisht i arsyetuar duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën mbështetet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 36, datë 25.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është kontradiktor, pasi në pjesë të caktuara të tij ka thënie që kundërshtojnë njëra tjetrën. Kështu, ndërsa Kolegji konstaton se në

"...dosjen gjyqësore nuk rezulton asnjë akt i marrjes së tokës në pronësi apo akte të tjera të nxjerra në bazë të ligjit të cilat legjitimonin paditësen në paraqitjen e kërkimeve të veta", ai, më poshtë, shprehet se *"...Ka rezultuar e provuar nga të gjitha provat e ndodhura në dosjen gjyqësore që i janë nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor që në momentin që paditësja ka marrë dhe paraqitur certifikatën e pronësisë..."*. Më tej në arsyetimin e vendimit vërehet: *"...rezulton në çështjen objekt gjykimi që paditësi e ka fituar titullin e pronësisë (nisur nga certifikata e saj e pronësisë paraqitur para gjykatës) më vonë se kur pala e paditur u pajis nga organet kompetente me leje shfrytëzimi.*".

19. Pra, në një pjesë të vendimit Kolegji shprehet se nuk provohet pronësia e paditësit dhe në një pjesë tjetër të të njëjtit vendim, Kolegji i referohet certifikatës së pronësisë së paditësit si dokument i administruar si provë nga gjykatat më të ulëta. Më tej, megjithëse Kolegji vë në dyshim legjitimitetin e paditëses (kërkueses), ai sërish deklaron se i padituri ka shfrytëzuar sendin mbi bazën e një titulli të ligjshëm dhe veprimet e tij, "*qoftë edhe në pronën e paditëses*", në asnjë rast nuk mund të konsiderohen si në kundërshtim me ligjin (fq.4 e vendimit). Pra, nëse Kolegji arrin në përfundimin se paditësja nuk legjitimohet në kërkimet e veta, pasi i mungon titulli i pronësisë, atëherë ai nuk mund të pranojë si të provuar se paditësja është pronare e sendit të shfrytëzuar në mënyrë të ligjshme apo jo nga i padituri. Vendimi i Kolegjit duhet të jetë i argumentuar dhe bindës për të mos lënë dyshime për asnjë nga palët lidhur me motivet ose shkaqet e prishjes së vendimeve të dy gjykatave më të ulëta, aq më tepër kur hetimi gjyqësor prej këtyre të fundit konsiderohet si i paplotë nga Gjykata e Lartë.

20. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses janë të bazuara dhe duhen pranuar, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkueses, duke mosrespektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-850 (182), datë 7.3.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur pranimin e kërkesës së Age Musteqja dhe për pasojë ka shfuqizuar vendimin nr. 00-2013-850 (182), datë 7.3.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Shumica ka arsyetuar se ky vendim ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkueses, duke mos respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih paragrafin nr. 20 të vendimit*). Në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, por mendoj se ajo duhej t'i jepte përgjigje edhe pretendimit të kërkueses lidhur me cenimin e parimit e sigurisë juridike. Për këtë arsye e çmoj me vend të shprehem me mendim paralel.

2. Siguria juridike qëndron në një lidhje unike me parimin e shtetit të së drejtës dhe të dyja bashkë me atë të demokracisë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në një shtet dhe shoqëri demokratike. Jurisprudenca e kësaj Gjykate referon te ky parim konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar dhe të pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike është një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore (*shih vendimet nr. 33, datë 24.6.2010, nr. 46, datë 11.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Sipas legjislacionit procedural shqiptar janë vendime përfundimtare, vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të shkallës së parë, në qoftë se nuk janë ankimuar brenda afatit të ankimit, si dhe vendimet e gjykatës së apelit të cilat janë të formës së prerë. Ndaj tyre organet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore kanë detyrimin për t'i venë menjëherë në zbatim.

4. Gjithashtu Gjykata ka vlerësuar se në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe fakteve nga Gjykata e Lartë dhe nxjerrja e konkluzioneve të kundërta nga ato të gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*)

5. Në rastin në shqyrtim, nga rrethanat e çështjes, sikurse thekson edhe shumica, rezulton se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me rolin e saj si gjykatë ligji, ka marrë prerogativat e një gjykate fakti, duke tejkaluar kompetencat e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligjin procedural civil. Edhe lidhur me fitimin i titullit të pronësisë mbi sendin nga ana e kërkueses, Gjykata e Lartë ka arritur në një përfundimin të ndryshëm nga vendimet e gjykatave të faktit duke e mbështetur vendimin e saj në fakte e rrethana, të cilat nuk janë pranuar si të vërteta nga ato gjykata si dhe duke anashkaluar konkluzionet e këtyre gjykatave mbi provat e administruara në gjykim. Gjykata e Lartë shprehet se paditësja është bërë pronare më vonë se kur pala e paditur u pajis me leje shfrytëzimi, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta (*shih paragrafët nr. 11-12 të vendimit*).

6. Në këto kushte, jam i mendimit se një vendim i tillë i Gjykatës së Lartë bie ndesh edhe me pritshmëritë e ligjshme të kërkueses dhe cenon besimin e saj tek drejtësia për më tepër kur vendimi ka marrë formë të prerë (përfundimtare) në gjykatën e apelit. Pikërisht në këndvështrimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike, duhej trajtuar edhe arsyetimi i shumicës, sipas të cilës, nëse Kolegji Civil arrin në një përfundim të ndryshëm nga ai i gjykatave më të ulëta, atëherë ai duhet të prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë për rigjykim çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Ai në asnjë rast nuk mund të zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore (*shih paragrafin nr. 13 të vendimit*).

7. Nga sa më sipër, çmoj se vendimi i Gjykatës së Lartë, krahas parimeve të evidentuara nga shumica, i ka cenuar kërkueses edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosrespektimit të parimit të sigurisë juridike.

Anëtar: Vladimir Kristo